



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:121555

Datë: 10.02.2025

Numri i dokumentit: 06827684

P.nr.846/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtarja e vetëm gjykuese Naime Krasniqi Jashanica, me zyrtaren ligjore/praktikante Medina Zeqiri në çështjen penale kundër të pandehurit Albin Dibrani dhe Armend Topallaj, për shkak të veprës penale *Vjedhja* nga neni 313, par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 366, par.1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.956/24 të dt. 23.04.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 07.02.2025, në praninë e prokurorit të shtetit Jeton Koca dhe të pandehurit Albin Dibrani me mbrojtësin e tij Av. Shukri Sylejmani, te pandehurit Armend Topallaj me mbrojtësin e tij Av. Arianit Kaçandolli, me datë 10.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

TE AKUZAURIT:

ALBIN DIBRANI, nga babai M. dhe nëna N., e gjinisë H., data e lindjes ... në..., me vendbanim në rrugën "..." nr... në Mitrovicë, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës dhe

ARMEND TOPALLAJ, nga babai Sh. dhe nëna H., e gjinisë S., data e lindjes..., në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "...", Lagja ...në Mitrovicë, i pa martuar, i pa punë, student, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

J A N Ë F A J T O R

Me datë 09.01.2024, rreth orës 21:30, në marketin "D..." që gjendet në rrugën "Fahri Fazliu" në Prishtinë, të pandehurit Albin Dibrani dhe Armend Topallaj duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje dhe me qëllim që me përvetësimin e pasurisë së huaj të luajtshme, vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë hyrë në market dhe nga raftet kanë marr çokollata të ndryshme, ku më pas janë larguar me vrap nga marketi pa e

bërë pagesën e tyre, me ç' rast të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerën prej 30.00 euro -,

- Me këtë të pandehurit Albin Dibrani dhe Armend Topallaj, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

II. Me datën 09.01.2024, në rrugën "Fahri Fazliu" në Prishtinë, të pandehurit Albin Dibrani dhe Armend Topallaj, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pa leje kanë poseduar armë të ftohta "thika"¹, në atë mënyrë që pas kryerjes së veprës penale nga dispozitivi I i kësaj aktakuze, janë ndaluar nga Policia dhe gjatë kontrollit, të pandehurve iu është gjetur në posedim nga një thikë, të cilat më pas u janë sekuestruar,

- Me këtë të pandehurit Albin Dibrani dhe Armend Topallaj, secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 269 par.2 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 449, 452 të KPPK-së:

E GJYKON

TË AKUZUARIN: Albin Dibrani i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej pesë (5) muajsh, i cili dënim **NUK** do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen tjetër vepër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti. Dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) euro, i akuzuari është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh, por jo me larg se 3 muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

TË AKUZUARIN: Armend Topallaj i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej pesë (5) muajsh, i cili dënim **NUK** do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen tjetër vepër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti. Dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) euro, i akuzuari është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh, por jo me larg se 3 muaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari Albin Dibrani eventualisht nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën në shumën si më lart, atëherë gjykata në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do t' ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që 20€ (njëzet) Euro gjobë, do ti llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Nëse i akuzuari Armend Topallaj eventualisht nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën në shumën si më lart, atëherë gjykata në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do t' ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që 20€ (njëzet) Euro gjobë, do ti llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

I dëmtuari përfaqësi i autorizuar i maketit "D..." njoftohet për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko- civil.

Ne kuptim te nenit 366 par.1 te KPRK-se, konfiskohen dy thikë me teh gjatësi nga 9 cm.

DETYROHEN te pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€) si dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën prej njëzetë (20€) euro.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 30.04.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.956/24, ndaj te pandehurve te larte cekur se ekziston dyshimi i bazuar mire se kanë kryer veprat penale *Vjedhja* nga neni 313, par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 te KPRPK-se dhe *Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve* nga neni 366, par.1 te KPRK-se.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestarë, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPRPK-së, kompetencë territoriale për tu gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale është kryer në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje. Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se me qenë se vepra penale *Vjedhja* nga neni 313 par.2 te KPRK-se është dënueshme me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, lidhur me par.1 është e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Dhe vepra penale *Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve* nga neni 366, par.1 te KPRK-se është e dënueshme me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar

Gjyqtarja e vetme gjykuese ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.02.2025, në të cilën seancë të pandehurve te larte cekur, pasi që është njoftuar me të drejtat e tyre, i është lexuar aktakuza dhe gjyqtarja vetme gjykuese është e bindur se te pandehurve e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohe lidhur me fajësinë, ku i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë lidhur me veprën e cila i vihet në barrë.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, me rastin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, si dhe i bazuar në provat materiale si në aktakuzë ndërsa gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese si dhe rrethanat e tjera rënduese,

siç janë të përcaktuara me aktakuzë, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit. Prokuroria nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe vlerësojmë që pranimi i fajësisë të jetë rrethane lehtësuese dhe ato rëndësuese të parapara me ligj. Lidhur me lartësinë e le në kompetencë të Gjykatës të bazuar sipas ligjit.

Av.Shukri Sylejmani në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pas konsultimeve që i kemi bërë me të mbrojturin tim e që e ka kuptuar peshën e veprës dhe i ka kuptuar edhe lehtësitë që mund ti ofrohen me rastin e pranimit të fajësisë e ka pranuar me vullnetin e plotë fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon prokuroria. Propozoj Gjykatës sa i përket sanksionit penal lusim Gjykatën të shqiptoj një dënim me gjobe dhe unë si mbrojtës i tij jap pëlqimin edhe dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me burg

I pandehuri Albin Dibrani në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se përkrah fjalët e avokatit.

Av.Arianit Kaçandolli në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pas konsultimeve që i kemi bërë me të mbrojturin tim e që e ka kuptuar peshën e veprës dhe i ka kuptuar edhe lehtësitë që mund ti ofrohen me rastin e pranimit të fajësisë e ka pranuar me vullnetin e plotë fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon prokuroria. Dhe lusim Gjykatën që pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im ta merr si të ligjshëm. Propozoj që të marre për baze rrethanat lehtësuese e në veçanti pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës dhe gatishmërinë dhe pendimin e thelle të të mbrojturit tim i cili premtion Gjykatë se në të ardhmen nuk do të persëritë veprën penale po ashtu sa i përket marrjes së dënimit propozoj Gjykatës që ta marr një dënim me gjobe.

I pandehuri Armend Topallaj në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se përkrah fjalët e avokatit.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit.

Provat që janë administruar dhe vlerësuara

Gjykata, pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, nuk është lëshuar në administrimin e provave, mirëpo me rastin e pranimit të fajësisë ka konstatuar se pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës si: Deklaratat e të pandehurve Albin Dibrani dhe Armend Topallaj të dhëna në Prokurori, Deklarata e dëshmitares E.B. e dhënë në Polici dhe Vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 09.01.2024.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra penale *Vjedhja* nga neni 313 par.2 të KPK-se për të cilën akuzohen të akuzuarit e larte cekur është e sanksionuar me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, lidhur me par.1 është e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Dhe vepra penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366, par.1 të KPRK-se për të cilën akuzohen të akuzuarit e larte cekur është e sanksionuar me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Andaj gjykata duke u bazuar për mos u kufizuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ndaj të pandehurit ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale, dhe pendimin e tyre për kryerjen e veprave penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të akuzuarve gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale. Andaj Gjkata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me këtë dënim të kushtëzuar me burg të shqiptuar ndaj të akuzuarve dhe dënimi me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Gjkata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 450 paragrafi 2, pika 2.6 e lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, e ngarkoi të akuzuarin lidhur me shpenzimet e procedurës, duke e obliguar të njëjtit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30.00 euro.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin juridiko civil për realizim të kërkesës pasurore juridike është marrë konform nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së.

Gjkata vendosi në konfiskimin armëve të ftohtë në kuptim të nenit 366, par.1 të KPRK-se.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.846/24, data 10.02.2025

Gjyqtarja e vetme gjykyese
Naime Krasniqi Jashanica

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.